



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 454/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçanë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, rreth orës 16:00 në Qendrën e Votimit nr. 0106 C në Izniq- Deçan vetem brenda objektit të vendvotimit, militant e AAK-së, qëllimisht kanë ndalur rrymën elektrike dhe më këtë rastë kanë manipuluar më vota. Më këtë rastë konsiderojmë se është bërë shkelje e nenit 34.1 të LZP si dhe neni 3.6 të Rregullave Zgjedhore nr. 09/2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të subjektit politik PDK, pretendohet se subjekti politik AAK, ka manipuluar me vota, ndonëse manipulimi është bërë nga subjekti politik AAK, PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 454/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*